



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 135

Tiranë – E martë, 29 korrik 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1, datë 4.7.2025	Për miratimin e metodologjisë “Për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, për vitin buxhetor 2025”..... 19307
Udhëzim i përbashkët i kryetarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe i ministrit të Financave nr. 16, datë 8.7.2025	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 30, datë 23.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit”, të ndryshuar..... 19310
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 704, datë 21.7.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Estonisë..... 19310
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 705, datë 21.7.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës..... 19313
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 131, datë 7.7.2025	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Nova Solar System’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 50 <i>mw</i> ”..... 19314
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 132, datë 7.7.2025	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 31.7.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë ‘H.K. HEC Grabova 2’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”..... 19315
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 134, datë 7.7.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Power Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 25 <i>mw</i> 19317

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 135, datë 7.7.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Power Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	19318
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 136, datë 7.7.2025	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	19319
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 137, datë 7.7.2025	Mbi heqjen e licencës së shoqërisë “Energy Supply – AL” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	19320
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 138, datë 7.7.2025	Mbi heqjen e licencës së shoqërisë “Energy Supply – AL” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	19322
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 139, datë 7.7.2025	Mbi heqjen e licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike....	19323
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 140, datë 7.7.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Zenina” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	19324
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 141, datë 7.7.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	19326
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 142, datë 7.7.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k.....	19328
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 143, datë 7.7.2025	Mbi kërkesën e shoqërisë “Hydropower” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj.....	19331
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 306/7, datë 24.7.2025	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitim/rikonstruksion i Urës së Viroit”.....	19332
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër nr. 171 (33-2025-584), datë 13.5.2025	Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Fadil Seferi.....	19333



UDHËZIM
Nr. 1, datë 4.7.2025

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË
“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT
PËR SHPËRNDARJEN DHE
PËRDORIMIN E SUBVENCIONEVE
SHTETËRORE, PËR OFRUESIT E
SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E
UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, PËR
VITIN BUXHETOR 2025”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 1, të pjesës 1, të skedulit 1 të ligjit 25/2023, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri”; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”; të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar; të vendimit nr. 431, datë 11.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr. 9, datë 20.7.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ

1. Zbatimin e metodologjisë “Për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, për vitin buxhetor 2025”, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve.

3. Udhëzimi nr. 2, datë 26.3.2024, “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, për vitin buxhetor 2024”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

LIDHJA NR. 1

METODOLOGJI

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR
SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E
SUBVENCIONEVE SHTETËRORE, PËR
OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË SEKTORIN
E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, PËR VITIN
BUXHETOR 2025**

Kjo metodologji është hartuar në mbështetje të pikës 13, shkronja “j”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve”, e ndryshuar; objektivit specifik 4.2 të Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me ujë dhe Kanalizimeve të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 448, datë 23.7.2023, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, “Politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”.

Detajimi i fondit të subvencionit dhe përdorimi i tij do të bëhet si më poshtë:

1. Subvencioni do të shpërndahet nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (në vijim “AKUK”) në masën e planifikuar në ligjin vjetor të buxhetit, në përputhje me zërin buxhetor subvencione, me llogari ekonomike (603) dhe të gjitha shtesave të tjera të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Subvencioni sipas pikës 1 të kësaj Metodologjie të do të shpërndahet vetëm për të subvencionuar konsumin e parashikuar në pikën 4 të kësaj Metodologjie, për kategoritë në nevojë.

3. Kategoritë në nevojë që përfitojnë nga kompensimi për konsumin e sasisë minimale jetike të ujit të pijshëm, janë subjektet e parashikuara nga neni 7 i ligjit 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.



4. Kategoritë e përcaktuara në pikën 3 të kësaj Metodologjie do të kompensohen në masën 100% për vlerën e faturuar deri në sasinë 5 m³/muaj (pesë metër kub në muaj) ujë të pijshëm për kontratë, për të përmbushur nivelin minimal jetik. Për këto kategori do të subvencionohet edhe tarifa fikse, tarifa e kanalizimeve dhe e trajtimit të ujërave të ndotura urbane. Zbritja për kategoritë e përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi bëhet automatikisht në faturën mujore të gjeneruar nga shoqëria përkatëse ujësjellës-kanalizime.

5. Kompensimi jepet vetëm një herë për një familje, pavarësisht nëse ato mund të kenë në përbërje persona që përfshihen në më shumë se një nga grupimet e pikës 3 të kësaj Metodologjie, apo kanë në përbërje më shumë se një anëtar që i lind e drejta e përfitimit.

6. Prioriteti për përdorimin e fondit nga shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve (rajonale ose jo) është si më poshtë:

a) Shoqëritë e përdorin fondin për të akorduar çdo muaj, përmes një zbritjeje 100% në shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të kategorive, të përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi, deri në masën 5 m³/muaj.

b) Pjesa e mbetur e fondit të subvencionit, nëse do të jetë rasti, do të përdoret nga shoqëritë UK për mbulimin e kostos së energjisë elektrike, me kusht që shoqëritë të kenë mbi 75% të volumit të prodhimit të ujit me ngritje mekanike.

7. Janë të ligjshme për të përfituar nga subvencioni sipas pikës 1 të kësaj Metodologjie, vetëm shoqëritë UK që kanë nënshkruar kontratën e performancës me AKUK-në.

8. Shoqëritë që nuk kanë nënshkruar marrëveshjen e performancës me AKUK-në nuk do të rimbursohen për zbritjet e aplikuara sipas pikës 6 të kësaj metodologjie.

9. Zbritja e parashikuar në pikën 6, shkronja “a” të kësaj Metodologjie është e detyrueshme edhe për shoqëritë që nuk kanë nënshkruar kontratën e performancës. Kostoja e shoqërive UK që nuk kanë nënshkruar kontratën e performancës do të mbulohet nga fondet e vetë shoqërisë UK dhe vetëm pas nënshkrimit të kontratës së performancës, këto shoqëri janë të ligjshme të

përfitojnë nga subvencioni sipas pikës 1 të kësaj metodologjie.

10. Shoqëritë UK pajisen nga njësitë e qeverisjes vendore brenda juridiksionit territorial të tyre, në formë shkresore dhe elektronike, si dhe nëpërmjet Regjistrat Elektronik Kombëtar, nëse sistemet mund të komunikojnë automatikisht ndërmjet tyre, me listën e plotë të familjeve/individëve në nevojë nën juridiksionin e bashkisë, subjekt i trajtimit me ndihmë ekonomike, brenda datës 10 të çdo muaji, sipas formatit në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, i cili shoqërohet edhe nga vendimi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

11. Vlerësimi i nevojave për fondin e dhënë sipas pikës 6 të kësaj metodologjie, si dhe detajimi dhe shpërndarja nga AKUK-ja, në përputhje me këtë udhëzim, do të bazohet në të dhënat e raportuara nga shoqëritë UK pranë AKUK-së, në përputhje me kërkesat, formatin dhe afatet e përcaktuara prej tij.

12. AKUK-ja vlerëson dokumentacionin/të dhënat e paraqitur/a dhe bën shpërndarjen e subvencionit, për shoqëritë UK brenda vitit buxhetor 2025

13. AKUK-ja do të rimbursojë edhe faturën për muajt e ngelur të vitit paraardhës.

14. AKUK-ja llogarit vlerën e subvencionit, sipas pikës 6 të kësaj metodologjie, që do të përfitojë secila shoqëri UK dhe njofton shoqëritë si më poshtë:

a) në lidhje me subvencionin sipas pikës 6, shkronja “a”, të kësaj metodologjie llogaritja e AKUK-së bazohet në informacionin e paraqitur nga shoqëria UK, sipas shtojcës 2 të këtij udhëzimi;

b) në lidhje me subvencionin sipas pikës 6, shkronja “b”, të kësaj metodologjie llogaritja e AKUK-së bazohet në të dhënat e raportuara nga shoqëritë UK, sipas formateve të raportimit të miratuara nga AKUK-ja.

15. AKUK-ja, në zbatim të shkronjës “k”, të nenit 13, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve”, të ndryshuar, ka të drejtë të ushtrojë kontrollë nëpërmjet njësisë të posaçme të ngritur për këtë qëllim, për të vlerësuar mënyrën e përdorimit të fondit të akorduar për çdo shoqëri, që ka përfituar nga fondi i subvencionit.



SHTOJCA NR. 1

Logoja e Bashkisë

Prefektura

Bashkia _____

LISTË

Nr. __, datë ____

E FAMILJEVE/INDIVIDËVE NË NEVOJË PËR TRAJTIM ME NDIHMË
EKONOMIKE PËR PERIUDHËN _____

Mbështetur në ligjin nr. 57, datë 18.7.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; vendimin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror nr. __, datë __, në udhëzimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. __, datë __, “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, për vitin buxhetor 2025”, struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki i dërgon shoqërisë UK-së, listën e plotë të familjeve/individëve në nevojë, të cilët janë përfitues të statusit për trajtim me ndihmë ekonomike.

Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga vendimi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror nr. __, datë __, bashkëngjitur, ju informojmë se:

1. Janë miratuar si të ligjshëm për përfitues të ndihmës ekonomike _____ familje, lista bashkëlidhur;
 2. Individë me statusin e jetimit _____ persona, lista bashkëlidhur;
 3. Individë viktimë të trafikimit _____ persona, lista bashkëlidhur;
 4. Individë viktimë të dhunës në familje _____, lista bashkëlidhur;
 5. Prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh:
 - a) trinjakë _____ familje, lista bashkëlidhur;
 - b) katërnjakë _____ familje, lista bashkëlidhur;
 - c) pesënjakë e më shumë njëherësh _____ familje, lista bashkëlidhur;
 6. Fëmijë të vendosur në familje kujdestare 1 _____, lista bashkëlidhur;
 7. Fëmijë me aftësi të kufizuara të vendosur në familje kujdestare 2 _____, lista bashkëlidhur
- Lista e plotë e familjeve të propozuara në skemën e ndihmës ekonomike për periudhën e akorduar.

Nr.	Emri Atësia Mbiemri	Nr. i dosjes	Nr. i anëtarëve	Lloji i ndihmës	Nr. i kontratës UK

STRUKTURA PËRGJEGJËSE

Personi përgjegjës për ndihmën ekonomike Titullari/Personi i autorizuar
Emri Mbiemri firma Emri Mbiemri firma

Bashkia _____
Prefektura _____



SHTOJCA NR. 2

Logoja e UK-së

LISTË

Nr. _____ datë _____

E LLOGARITJES SË VLERËS SË SUBVENCIONIT PËR FAMILJET/INDIVIDËT NË NEVOJË PËR TRAJTIM ME NDIHMË EKONOMIKE PËR PERIUdhËN _____

Mbështetur në udhëzimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.____, datë ____, “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve”, për vitin buxhetor 2025, shoqëria UK dërgon listën e plotë të familjeve/individëve në nevojë, të cilët janë përfitues të subvencionit, sipas udhëzimit nr.____, datë ____, dhe që gëzojnë statusin për trajtim me ndihmë ekonomike.

Nr.	Emri Atësia Mbiemri	Nr. i kontratës UK	Vlera e faturës mujore	Sasia ujë dhe kanalizime m ³	Tarifa ujë	Tarifa kanalizime	Tarifa fikse	Sasia e zbritur	Vlera e zbritur

Titullar
Emri Mbiemri
firma

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 16, datë 8.7.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 30, DATË 23.12.2014, “PËR
PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET E
RADIOKOMUNIKACIONIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, ministri i financave dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP),

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Financave dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) nr. 30, datë 23.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit”, të ndryshuar, në pikën 6, fjalia e parë ndryshon me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“Për shërbimin e kryer, AKEP-i mban 10% komision të llogaritur mbi masën e tarifave, që ka arkëtuar dhe deklaron dhe paguan në llogarinë e

drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar 90% të shumës së arkëtuar.”

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES
TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Gentian Sala

URDHËR
Nr. 704, datë 21.7.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E ESTONISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në pikën 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontenier të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Tartu	Maksa	Sudaste*
Viljandi	Abja	Veskimäc*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Estonisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin

janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.



2.4. Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime

eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e



përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 647, datë 3.7.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Estonisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 705, datë 21.7.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Extremadura	Badajoz	Azuaga*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.



5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM
Nr. 131, datë 7.7.2025

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 242, DATË
3.8.2023, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘NOVA SOLAR SYSTEM’
SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET
TË INSTALUAR 50 mw”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 1986 prot., datë 1.7.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2024, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Nova Solar System’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw”;

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Nova Solar System” sh.p.k.

- Me vendimin nr. 242, datë 3.8.2023, Bordi i ERE-s ka licencuar shoqërinë “Nova Solar System” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë

elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 30-vjeçar, me kusht që para fillimit të operimit të depozitohet në ERE aktmarrëveshjen me “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., për miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes.

- Në dispozitivin e këtij vendimi, ERE, gjithashtu, ka vendosur: “2. Shoqëria të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, por jo më vonë se data 21.10.2024. 3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të aktmarrëveshjes me OST sh.a. dhe informacionit në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së paraprake.”.

2. Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria ka depozituar në ERE, me shkresën nr. 16 prot., datë 7.10.2024, marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit, të nënshkruar me OST sh.a., më datë 3.7.2024, përpara fillimit të operimit më 30.7.2024.

- Me shkresën nr. 21 prot., datë 8.11.2024, ka dorëzuar raportimin për sasinë e energjisë së prodhuar për periudhën korrik–tetor 2024, në kuadër të aplikimit për pajisje me garanci origjine, duke konfirmuar se punimet ndërtimore janë kryer brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake (deri më 21.10.2024).

- Nga informacioni i depozituar dhe të dhënat e OST-së, rezulton se impianti ka filluar operimin brenda afateve të parashikuara dhe është hedhur energji në rrjet që nga muaji korrik 2024.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Duke marrë në konsideratë përcaktimet e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023, rezulton se shoqëria i ka filluar punimet ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake, për sa kohë ka hyrë në prodhim në muajin korrik 2024.

- Shoqëria “Nova Solar System” sh.p.k. ka pasur një marrëveshje të vlefshme lidhjeje me rrjetin e transmetimit, të nënshkruar më datë 3.7.2024, përpara fillimit të operimit të impiantit më datë 30.7.2024. Kjo marrëveshje është depozituar në ERE në muajin tetor 2024, përmes shkresës nr. 16 prot., datë 7.10.2024, protokolluar në ERE me nr. 2054 prot., datë 8.10.2024.

- Shoqëria ka përmbushur kushtin e përcaktuar në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023, duke filluar punimet e ndërtimit të



centralit fotovoltaiik brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake, e cila skadonte më datë 21.10.2024.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Kushtet e vendosura në pikat 2 dhe 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Nova Solar System’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 50 mw”, janë përmbushur nga ana e shoqërisë dhe si të tilla duhet të shfuqizohen.

- Edhe kushti i vendosur në pikën 1, të vendimit nr. 242/2023, është plotësuar dhe për rrjedhojë pika 1 e dispozitivit të vendimit nr. 242/2023, ndryshohet.

- Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 113 përcakton se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj, si të tillë, pikat 2 dhe 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023, duhet të shfuqizohen, pasi shoqëria “Nova Solar System” sh.p.k. i ka përmbushur kushtet e vendosura nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023, ndryshon dhe bëhet:

“1. Të licencojë shoqërinë “Nova Solar System” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 30-vjeçar.”.

2. Pikat 2 dhe 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023, shfuqizohen.

3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “Nova Solar System” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “FTL” sh.a., “OST” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 132, datë 7.7.2025

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 157, DATË 31.7.2024 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘H.K. HEC GRABOVA 2’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 1911/1 prot., datë 1.7.2025 “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 31.7.2024 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘H.K. HEC Grabova 2’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike””,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 157, datë 31.7.2024, ka licencuar shoqërinë “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Grabova 2”, me kapacitet total të instaluar 10.8 mw, me vendndodhje në pellgun e përroit të Grabovës, Gramsh, qarku Elbasan, duke filluar ky afat nga data 24.10.2024 deri më 14.9.2052.

- Në dispozitivin e këtij vendimi, ERE ka vendosur që shoqëria “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k. të depozitojë në ERE qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe/ose



amendimin e kontratës së nënshkruar, në lidhje me kërkesën e saj për zgjatjen e afatit të datës së fillimit të operimit të hidrocentralit “Grabova 2”. Gjithashtu, është kërkuar që shoqëria të dorëzojë në ERE kontratën e kredisë së rishikuar, të nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., brenda muajit tetor 2024. Ky vendim do të jetë objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të dokumentacionit të sipërpërmendur.

2. Kërkesa e shoqërisë dhe dokumentacioni i depozituar

- Shoqëria “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k., me shkresën nr. 50 prot., datë 20.6.2025, protokolluar në ERE me nr. 1911 prot., datë 20.6.2025, ka kërkuar shfuqizimin e pikës 3 të vendimit nr. 157, në funksion të përmbushjes së këtij kushti.

- Me shkresën nr. 90 prot., datë 18.10.2024, protokolluar në ERE me nr. 996/12 prot., datë 18.10.2024, shoqëria ka depozituar kontratën e kredisë së nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., me nr. 6896 repertori, nr. 2851 koleksioni, datë 17.9.2024.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me nenin 9, pikën 1.2, germën “b” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, aplikuesit janë të detyruar të dorëzojnë dokumente që vërtetojnë mbështetjen financiare për realizimin e projektit.

- Nga shqyrtimi i kontratës së depozituar, rezulton se kjo kontratë përmban elementët themelorë të mbështetjes financiare për ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentralit “Grabova 2”, duke përmbushur kërkesat e përcaktuara në rregullore.

- Kontrata është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të vendimit nr. 157/2024, çka përbën përmbushje të plotë të detyrimit të vendosur nga Bordi i ERE-s.

- Megjithatë shoqëria “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k. ka përmbushur kushtin e përcaktuar në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 157, datë 31.7.2024, dhe ka depozituar në afat kontratën e kredisë së nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., kushti i përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi vijon të mbetet në proces verifikimi. Deri në këtë fazë, ERE nuk ka administruar ende qëndrimin zyrtar të

Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe/ose amendimin e kontratës koncensionare lidhur me kërkesën për zgjatjen e afatit të fillimit të operimit të hidrocentralit.

- Për rrjedhojë, ERE do të vijojë korrespondencën me shoqërinë “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k., për të ndjekur përmbushjen e këtij detyrimi, në mënyrë që të sigurohet respektimi i kërkesave të vendimit nr. 157/2024 dhe të kuadrit rregullator përkatës.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në funksion të sa parashtruar më sipër, vlerësohet se kushti i vendosur në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 157, datë 31.7.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘H.K. HEC Grabova 2’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, është përmbushur nga ana e shoqërisë dhe si i tillë duhet të shfuqizohet.

- Si rrjedhojë e shfuqizimit të pikës 3 të dispozitivit të vendimit nr. 157/2024, vlerësohet të ndryshojë dhe pika 4 e këtij vendimi, e cila do të formulohet si vijon: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të tij.”.

- Bazuar në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj, vlerësojmë që pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 157, datë 31.7.2024, duhet të shfuqizohet pasi shoqëria “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k. ka përmbushur kushtin e vendosur nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 157, datë 31.7.2024, shfuqizohet.

2. Pika 4 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 157, datë 31.7.2024, ndryshon si më poshtë vijon: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të tij.”.

3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “H.K. HEC Grabova 2” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe



Energjisë, FTL sh.a., OSSH sh.a. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 134, datë 7.7.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “POWER ENERGY” SHPK
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET
PRODHUES 25 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1923/1 prot., datë 30.6.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Power Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Power Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1923 prot., datë 23.6.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 25 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, fshati Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezultoi se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave (“a”, “b” dhe “c”), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaroi se nuk i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, se angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të ERE-s, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave (“a”, “b”, “c” dhe “d”).

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germës “a”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave (“a”, “b” dhe “c”).

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 310, datë 4.6.2025, “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘Power Energy’ sh.p.k.”;



- Shoqëria ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 5129 rep., nr. 2337 kol., datë 13.6.2025, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 30 mw, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3038, Njësia Administrative Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘Power Energy’ sh.p.k.”;

- Shoqëria është pajisur me VNM paraprake, lëshuar më 17.2.2025 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Centrali fotovoltaike ‘Power Energy Solar’ 25 mw”.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë një letër të përditësuar të bankës, ku të shprehet vlera/përqindja me të cilën banka është aktualisht e interesuar të financojë këtë projekt, si dhe të dokumentojë disponimin e vlerës së mbetur nga vlera totale e projektit sipas kontratës me MIE-n.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **germa “c”:** Shoqëria të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes me OST sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Power Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 25 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Power Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 135, datë 7.7.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “POWER ENERGY” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1924/1 prot., datë 30.6.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Power Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Power Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1924 prot., datë 23.6.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.



- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duke plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaron se nuk i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të ERE-s, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germës “a”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2.5 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar informacionin mbi sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë gjatë 5 (pesë) viteve të ardhshme të licencës.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3, Dokumentacioni financiar dhe fiskal germa “b”: Shoqëria të dokumentojë se disponon vlerën e mbetur që i nevojitet për të garantuar të paktën një muaj të ushtrimit të aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike;

germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE një plan 5-vjeçar të dedikuar për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Power Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Power Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 136, datë 7.7.2025

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË
BORDIT TË ERE-s, LIDHUR ME
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “ENERGOVIA.ALBANIA”
SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1693/10 prot., datë 1.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë



‘Energovia.Albania’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike”,

konstatohet se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

Fillimi i procedurës së licencimit

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 113, datë 3.6.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 4.6.2025 dhe 5.6.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 13.6.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

Kërkesa për dokumentacionin plotësues

- ERE, me shkresën nr. 1693/7 prot., datë 5.6.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim. Duke qenë se shkresa e mësipërme është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar, ERE i ka dërguar shoqërisë, me *email*, një kopje të skanuar të shkresës, në datën 11.6.2025.

Dorëzimi dhe vlerësimi i dokumentacionit plotësues

- Në datën 20.6.2025, shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit të munguar, ndërsa për dëshminë e penalitetit për administratorin, shoqëria ka bërë me dije se do ta depozitojë në ERE sapo të pajiset me të dhe të përkthehet. Sa referuar në *email* është depozituar dhe fizikisht në protokollin e ERE-s.

Shtyrja e afatit të vendimmarrjes

- Referuar nenit 14, pika 3 të rregullores, Bordi i ERE-s mund të zgjatë afatin e vendimmarrjes deri në 30 ditë, kur dokumentacioni nuk është i plotë.

- Për sa parashikuar nga rregullorja dhe në kuptim të sa bërë me dije nga shoqëria, që do të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore të administratorit sapo të pajiset me të, për t’i dhënë mundësi shoqërisë që të depozitojë këtë dokument, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e saj për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë

brenda 20 (njëzet) ditëve vërtetimin për gjendjen gjyqësore të administratorit të saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 137, datë 7.7.2025

MBI HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGY SUPPLY – AL” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, germa “ç” dhe 9, germa “c”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.2, germa “ç”, të “Kushteve të



licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 98, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1246/5 prot., datë 2.7.2025, të grupit të punës “Mbi heqjen e licencës së furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Energy Supply-AL’ sh.p.k.”

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 88, datë 24.4.2025, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 310, seria FK15/F21, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy Supply – AL” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 5, datë 2.12.2011, rinovuar me vendimin nr. 123, datë 14.10.2015 dhe nr. 14, datë 20.1.2021.

- Vendimi për fillimin e kësaj procedure u mor pasi shoqëria nuk kishte shlyer pagesën rregullatore ndaj ERE-s për vitin 2024, duke rezultuar debitore për këtë detyrim dhe nuk kishte depozituar asnjë dokument apo argument që të justifikonte moszbatimin e tij.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim me shkresën nr. 1337/1 prot., datë 30.4.2025, si dhe i ka dërguar një kopje të skanuar të shkresës në adresën e e-mail-it të regjistruar pranë ERE-s. Shkresa fizike është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar me shënimin “i panjohur”, ndërkohë që kontakti telefonik ka rezultuar i pamundur, pasi numri ishte i fikur.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 88, datë 24.4.2025, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 89, datë 26.5.2025. Në këto kushte, afati 30-ditor për paraqitjen e kundërshtimeve apo dokumentacionit përkatës llogaritet të fillojë nga data e botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

- Pavarësisht përpjekjeve të ERE-s për të njoftuar shoqërinë nëpërmjet kanaleve të disponueshme të komunikimit, është detyrim i të licencuarit të mbajë të përditësuara të dhënat e kontaktit pranë ERE-s. Në çdo rast, konsiderohet se shoqëria është njoftuar për vendimin përmes publikimit në Fletoren Zyrtare, siç parashikohet nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.

- Në përfundim të afatit 30-ditor, më datë 26.6.2025, duke e përllogaritur këtë afat nga botimi në Fletoren Zyrtare, rezulton se shoqëria “Energy Supply – AL” sh.p.k. nuk ka shlyer pagesën rregullatore, nuk ka paraqitur ndonjë shpjegim apo

dokument për situatën e krijuar dhe nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për të shmangur shkakun ligjor që çoi në fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenin 5, germa “ç” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe pikën 6.2, germa “ç” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, parashikohet se: *ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.*

- Me heqjen e licencës, shoqëria nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte pajisur me licencë.

- Pavarësisht vendimit për heqjen e licencës, shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të shlyer detyrimet e prapambetura, përfshirë pagesën rregullatore të vitit 2025, miratuar me vendimin e Bordit të ERE, nr. 112, datë 23.5.2025, i ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi në kohën kur shoqëria ende gëzonte statusin e subjektit të licencuar.

- Mbledhja e këtyre detyrimeve do të realizohet në rrugë gjyqësore, sipas legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 310, seria FK15/F21, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy Supply – AL” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 5, datë 2.12.2011, rinovuar me vendimin nr. 123, datë 14.10.2015 dhe nr. 14, datë 20.1.2021.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë “Energy Supply – AL” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të



bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 138, datë 7.7.2025

MBI HEQJEN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “ENERGY SUPPLY – AL”
SHPK NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, germa “ç”, dhe 9, germa “c” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 5.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2026; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1246/5 prot., datë 2.7.2025, të grupit të punës “Mbi heqjen e licencës së furnizimit dhe të tregimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Energy Supply-AL’ sh.p.k.”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 89, datë 24.4.2025, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 309, seria T15/T20, për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy Supply – AL” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 6, datë 2.2.2011, rinovuar me vendimin nr. 122, datë 14.10.2015 dhe nr. 13, datë 20.1.2021.

- Vendimi për fillimin e kësaj procedure u mor pasi shoqëria nuk kishte shlyer pagesën rregullatore ndaj ERE-s për vitin 2024, duke rezultuar debitore për këtë detyrim dhe nuk kishte depozituar asnjë

dokument apo argument që të justifikonte moszbatimin e tij.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim me shkresën nr. 1337/1 prot., datë 30.4.2025, si dhe i ka dërguar një kopje të skanuar të shkresës në adresën e *e-mail*-it të regjistruar pranë ERE-s. Shkresa fizike është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar me shënimin “i panjohur”, ndërkohë që kontakti telefonik ka rezultuar i pamundur, pasi numri ishte i fikur.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 89, datë 24.4.2025, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 89, datë 26.5.2025. Në këto kushte, afati 30-ditor për paraqitjen e kundërshtimeve apo dokumentacionit përkatës llogaritet të fillojë nga data e botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

- Pavarësisht përpjekjeve të ERE-s për të njoftuar shoqërinë nëpërmjet kanaleve të disponueshme të komunikimit, është detyrim i të licencuarit të mbajë të përditësuara të dhënat e kontaktit pranë ERE-s. Në çdo rast, konsiderohet se shoqëria është njoftuar për vendimin përmes publikimit në Fletoren Zyrtare, siç parashikohet nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.

- Në përfundim të afatit 30-ditor, më datë 26.6.2025, duke e përlllogaritur këtë afat nga botimi në Fletoren Zyrtare, rezulton se shoqëria “Energy Supply – AL” sh.p.k. nuk ka shlyer pagesën rregullatore, nuk ka paraqitur ndonjë shpjegim apo dokument për situatën e krijuar dhe nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për të shmangur shkakun ligjor që çoi në fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenin 5, germa “ç” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe pikën 5.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike”, parashikohet se: *ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.*

- Me heqjen e licencës, shoqëria nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte pajisur me licencë.

- Pavarësisht vendimit për heqjen e licencës, shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të shlyer detyrimet e prapambetura, përfshirë pagesën



rregullatore të vitit 2025, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 23.5.2025, i ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi në kohën kur shoqëria ende gëzonte statusin e subjektit të licencuar.

- Mbledhja e këtyre detyrimeve do të realizohet në rrugë gjyqësore, sipas legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 309, seria T15/T20, për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy Supply – AL” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 6, datë 2.2.2011, rinovuar me vendimin nr. 122, datë 14.10.2015 dhe nr. 13, datë 20.1.2021.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë “Energy Supply – AL” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 139, datë 7.7.2025

MBI HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, germa “ç”, dhe 9, germa “c”, të rregullores “Për procedurat

e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.2, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 98, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1246/6 prot., datë 2.7.2025, të grupit të punës “Mbi heqjen e licencës së furnizimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Energia Gas and Power Albania’ sh.p.k.”

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 90, datë 24.4.2025, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 322, seria F15/F20, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 159, datë 28.12.2015, dhe rinovuar me vendimin nr. 209, datë 11.12.2020.

- Vendimi për fillimin e kësaj procedure u mor pasi shoqëria nuk kishte shlyer pagesën rregullatore ndaj ERE-s për vitin 2024, duke rezultuar debitore për këtë detyrim dhe nuk kishte depozituar asnjë dokument, apo argument që të justifikonte moszbatimin e tij.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim me shkresën nr. 1338/1 prot., datë 30.4.2025, dhe i ka dërguar kopje të skanuar të shkresës në adresën e e-mail-it të regjistruar pranë ERE-s.

- Shkresa fizike është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar, me shënimin “Larguar”, ndërkohë që kontakti telefonik që disponon ERE i përket një personi që nuk është më pjesë e shoqërisë.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 90, datë 24.4.2025, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 89, datë 26.5.2025. Në këto kushte, afati 30-ditor për paraqitjen e kundërshtimeve, apo dokumentacionit përkatës, llogaritet të fillojë nga data e botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

- Pavarësisht përpjekjeve të ERE-s për të njoftuar shoqërinë nëpërmjet kanaleve të disponueshme të komunikimit, është detyrim i të licencuarit të mbajë të përditësuarat të dhënat e kontaktit pranë ERE-s. Në çdo rast, konsiderohet se shoqëria është njoftuar për vendimin përmes



publikimit në Fletoren Zyrtare, siç parashikohet nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.

- Në përfundim të afatit 30-ditor, më datë 26.6.2025, duke e përlogaritur këtë afat nga botimi në Fletoren Zyrtare, rezulton se shoqëria “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k. nuk ka shlyer pagesën rregullatore, nuk ka paraqitur ndonjë shpjegim apo dokument për situatën e krijuar dhe nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për të shmangur shkakun ligjor që çoi në fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenin 5, germa “ç”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe pikën 6.2, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, parashikohet se: “ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE”.

- Me heqjen e licencës, shoqëria nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte pajisur me licencë.

- Pavarësisht vendimit për heqjen e licencës, shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të shlyer detyrimet e prapambetura, përfshirë pagesën rregullatore të vitit 2025, miratuar me vendimin e Bordit të ERE, nr. 112, datë 23.5.2025, i ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi në kohën kur shoqëria ende gëzonte statusin e subjektit të licencuar.

- Mbledhja e këtyre detyrimeve do të bëhet me rrugë gjyqësore, sipas procedurave ligjore në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 322, seria F15/F20, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 159, datë 28.12.2015, dhe rinovuar me vendimin nr. 209, datë 11.12.2020.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., “OST” sh.a.,

OSSH sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 140, datë 7.7.2025

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “ZENINA” SHPK, SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1618/4 prot., datë 2.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Zenina’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”,



konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “Zenina” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1618/2 prot., datë 20.5.2025, ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Zenina” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 25, datë 27.1.2025.

- Me shkresën nr. 1618 prot., datë 28.4.2025, shoqëria ka kërkuar lëshimin e një shkrese konfirmuese, si dhe dhënien e udhëzimeve në lidhje me vendosjen e aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të projektit nëpërmjet hipotekimit, si dhe barrësimin e kuotave të shoqërisë si garanci në favor të bankës.

- ERE, me shkresën nr. 1618/1 prot., datë 8.5.2025, i ka dhënë sqarimet referuar përcaktimeve të rregullores dhe në vijim, shoqëria, me shkresën nr. 1618/2 prot., datë 20.5.2025, ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj bankës.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar, ERE nëpërmjet shkresës me nr. 1618/4 prot., datë 3.6.2025, i ka bërë me dije mbi informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Shoqëria, me shkresën nr. 1618/6 prot., datë 13.6.2025, depozitoi informacion/dokumentacion plotësues, nga analizimi i të cilit u konstatua se vendimin i organeve drejtuese i depozituar nga shoqëria ishte pa numër dhe datë. Për këtë arsye, ERE i është drejtuar sërish shoqërisë me shkresën nr. 1618/7 prot., datë 19.6.2025, duke i kërkuar depozitim të vendimit në formën e duhur.

- Në përgjigje, shoqëria, me shkresën nr. 1618/8 prot., datë 26.6.2025, ka depozituar vendimin përkatës të organeve drejtuese të pajisur me numër dhe datë, duke plotësuar kështu tërësisht dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e mëtejshëm të aplikimit.

3. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Zenina” sh.p.k., rezultoi se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- **Neni 5, pika 2** – Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores.

4. Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- **Neni 5, pika 4** – Dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.

- **Neni 5, pika 5** – Shoqëria ka kërkuar që dokumentacioni shoqërues i kësaj procedure të mos jetë i hapur për publikun, pasi përmban informacione dhe të dhëna sensitive.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- **Pika 1** – Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës siguruese, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave.

- **Pika 2** – Janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror, si më poshtë vijon:

- **Germa “a”** – Ekstrakti historik i regjistrit tregtar: Shoqëria ka depozituar në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të saj, të vulosur elektronikisht nga QKB-ja në datën 13.6.2025.

- **Germa “b”** – Vendimi i organeve drejtuese: Është depozituar vendimi i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “Zenina” sh.p.k., që miraton vendosjen e barrës siguruese mbi kuotat.

- **Germa “c”** – Janë depozituar marrëveshjet përkatëse.

- **Pika 3** – Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.



6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Zenina” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkuar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja e huas dhe marrëveshja siguruese janë nënshkruar me banka vendëse, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguruese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Zenina” sh.p.k. si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.

2. Dhënia e autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “Zenina” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “Zenina” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Zenina” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 141, datë 7.7.2025

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “ARIS ALBANIA” SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1671/3 prot., datë 2.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Aris Albania’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Aris Albania” sh.p.k.,



është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1671/7 prot., datë 17.6.2025, ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguroese) për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj bankës “ABI Bank” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 55, datë 22.2.2021, i ndryshuar.

- Kjo kërkesë ka ardhur pasi, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit (ekstraktit të QKB-së) të depozituar me shkresën nr. 1671 prot., datë 5.5.2025, në kuadër të aplikimit për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave, u konstatua nënshkrimi i një marrëveshjeje siguroese, me anë të së cilës, shoqëria ka lënë kuotat e saj si kolateral në favor të “ABI Bank” sh.a.

- Në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga statusi i të licencuarit, shoqëria duhet të marrë autorizimin e ERE-s në lidhje me barrësimin e kuotave për të garantuar detyrimin ndaj të tretëve.

- Duke qenë se shoqëria “Aris Albania” sh.p.k., e ka nënshkruar marrëveshjen siguroese, pa marrë më parë miratimin e ERE-s, kjo e fundit, nëpërmjet shkresave nr. 1671/1 prot., datë 8.5.2025 dhe nr. 1671/3 prot., datë 2.6.2025, i ka kërkuar shoqërisë të paraqesë sqarimet e saj lidhur me sa më sipër. Në përgjigje, shoqëria, me shkresat nr. 1671/4 prot., datë 3.6.2025 dhe nr. 1671/5 prot., datë 4.6.2025, ka paraqitur sqarimet përkatëse.

- Në vijim, ERE, me shkresën nr. 1671/6 prot., datë 11.6.2025, ka sqaruar shoqërinë mbi dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, të cilin shoqëria e depozitoi pjesërisht nëpërmjet shkresës nr. 1671/7 prot., datë 17.6.2025.

- Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur, u konstatua se subjekti i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me një kërkesë për miratim/pëlqim në lidhje me procedurën e vendosjes së barrës siguroese mbi kuotat në favor të “ABI Bank” sh.a. Për këtë arsye, ERE, me *e-mail*-in e protokolluar nr. 1671/10 prot., datë 25.6.2025, i ka kërkuar shoqërisë të konfirmojë nëse ka marrë një përgjigje nga MIE.

- Shoqëria me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 1671/11 prot., datë 13.6.2025, u shpreh se nuk ka pasur një përgjigje nga MIE, gjithsesi, ashtu si dhe në rastet analoge, ERE do të njoftojë MIE-n për dhënien e këtij autorizimi, si dhe vlerësohet që ky vendim të jetë objekt rishikimi në rast se nga MIE do të depozitohet ndonjë qëndrim në lidhje me këtë kërkesë.

3. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Aris Albania” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- **Neni 5, pika 2** – kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores.

4. Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- **Neni 5, pika 4** – dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.

- **Neni 5, pika 5** – shoqëria nuk ka paraqitur asnjë kërkesë të tillë, ndaj konsiderohet se nuk e kërkon këtë kufizim.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- **Pika 1** – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës siguroese, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave.

- **Pika 2** – janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- *germa “a”* – shoqëria ka depozituar në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të saj, të vulosur elektronikisht nga QKB-ja, më datë 13.6.2025.

- *germa “b”* – është depozituar vendimi i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “Aris Albania”



sh.p.k. që miraton vendosjen e barrës siguruese mbi kuotat.

- *germa “c”* – janë depozituar marrëveshjet përkatëse.

- **Pika 3** – shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja e huas dhe marrëveshja siguruese janë nënshkruar me banka vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n **në rast të heqjes së barrës siguruese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.**

- Duke qenë se kontrata e nënshkruar midis shoqërisë dhe MIE-s parashikon marrjen e miratimit/konfirmimit të MIE-s në rast barrësimi të kuotave, vlerësojmë që të lihet kushti që ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në zbatim të pikës 3, si dhe në rast se nga MIE depozitohet një qëndrim në lidhje me kërkesën e bërë nga shoqëria.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj bankës “ABI Bank” sh.a (për kontratën datë 27.6.2022).

2. Dhënia e autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “ARIS ALBANIA” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të

tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria duhet të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në zbatim të pikave 2 dhe 3.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Aris Albania” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 142, datë 7.7.2025

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “ARIS ALBANIA” SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 7, 9, pika 4 dhe 5, dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-



s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1671/3 prot., datë 2.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Aris Albania’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Aris Albania” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1671/2 prot., datë 19.5.2025, ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave vetëm nga aksioneri z. A. C. tek aksioneri z. Sh. C.

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 55, datë 22.2.2021, i ndryshuar.

- Me shkresën nr. 1671 prot., datë 5.5.2025, shoqëria ka depozituar në ERE, kërkesën në lidhje me marrjen e autorizimit nga ERE për transferim kuotash, sipas vendimit të Asamblesë të Ortakëve.

- ERE, me shkresën nr. 1671/1 prot., datë 8.5.2025, ka sqaruar shoqërinë mbi dokumentacionin që duhet të depozitojë në zbatim të nenit 7 të rregullores nr. 235/2021, për të marrë autorizimin nga ERE.

- Në vijim, me shkresën nr. 1671/2 prot., datë 19.5.2025, shoqëria ka saktësuar kërkesën dhe ka depozituar dokumentacion plotësues për aplikimin.

- ERE, nëpërmjet shkresave nr. 1671/3 prot., datë 2.6.2025 dhe nr. 1671/8 prot., datë 19.6.2025, ka komunikuar me shoqërinë mbi dokumentacionin që rezultonte ende i paplotësuar për shqyrtimin e aplikimit. Shoqëria, me shkresën nr. 1671/9 prot., datë 20.6.2025, ka depozituar në ERE informacionin/dokumentacionin përkatës, nga analizimi i të cilit rezultoi se, shoqëria i është drejtuar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me kërkesë për dhënien e miratimit/pëlqimit për procedurën e transferimit të kuotave nga z. A. C. tek z. Sh. C.

- Në këto rrethana, ERE, me *e-mail*-in e protokolluar nr. 1671/10 prot., datë 25.6.2025, i ka

kërkuar shoqërisë të konfirmojë nëse ka marrë një përgjigje nga MIE.

- Shoqëria me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 1671/11 prot., datë 13.6.2025, është shprehur se deri në atë moment nuk ka marrë përgjigje nga MIE. Megjithatë, në përputhje me praktikën e ndjekur në raste të ngjashme, ERE do të njoftojë MIE-n për dhënien e autorizimit dhe vlerëson që ky vendim të jetë objekt rishikimi nëse ministria paraqet ndonjë qëndrim lidhur me këtë kërkesë.

3. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Aris Albania” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5 dhe 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- Neni 5, pika 2 – kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores.

4. Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 4 – dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.

- Neni 5, pika 5 – shoqëria nuk ka paraqitur asnjë kërkesë të tillë, ndaj konsiderohet se nuk e kërkon këtë kufizim.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7:

- Pika 1 – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet mbi ndryshimin e ortakut/aksionarit aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, një përsëritje të kandidatit të propozuar, informacion mbi kontributin financiar që do të japë.

- Pika 2 – janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:



- **Germa “a”** – është plotësuar emri i plotë i të licencuarit

- **Germa “b”** – është plotësuar adresën e saktë e të licencuarit.

- **Germa “c”** – është bërë një përshkrim mbi arsyet e ndryshimit të ortakut/aksionarit aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit.

- **Germa “d”** – është bërë një parashikim i efekti të pritshëm që do të ketë pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në ushtrimin e aktivitetit të licencuar.

- **Germa “e”** – është bërë një përshkrim i kandidatit të propozuar për të kontrolluar interesat e shoqërisë, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë.

- **Germa “f”** – është dhënë informacion mbi kontributin financiar që do të japë në ushtrimin e aktivitetit kandidati i propozuar për të kontrolluar interesat e të licencuarit.

- **Pika 3** – shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k., nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e nevojshme nga palë të treta, në rast se kërkohet prej tyre.

- Në referencë të nenit 9, pika 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. detyrohet që, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i reflektimit të ndryshimit të ortakut që kontrollon interesat e saj në regjistrin tregtar të QKB-së, të depozitojë në ERE ekstraktin historik të përditësuar, me qëllim sigurimin e dokumentimit zyrtar dhe të verifikueshëm të këtij ndryshimi, garantimin e informacionit të saktë dhe të përditësuar mbi kontrollin dhe strukturën e kapitalit të subjektit të licencuar si dhe respektimin e kuadrit rregullator për detyrimet e njoftimit ndaj autoritetit rregullator.

- Duke qenë se Kontrata e nënshkruar midis shoqërisë dhe MIE-s parashikon marrjen e miratimit /konfirmimit nga MIE në rast transferimi të

kuotave, vlerësohet që të lihet kusht shoqërisë që ky vendim të jetë objekt rishikimi nga ERE nëse nga MIE depozitohet ndonjë qëndrim në lidhje me kërkesën e bërë nga shoqëria.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k.

2. Ortaku kryesor i shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k. me 55% të kuotave të kapitalit, bëhet z. S. C.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k., nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrin tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i ndryshimit të ortakut që kontrollon interesat e saj.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në zbatim të pikave 3 dhe 4.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 143, datë 7.7.2025

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“HYDROPOWER” SHPK PËR MARRJEN
E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR
TRANSFERIMIN E ASETEVE FIKSE
TË SAJ

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 64, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1589/10 prot., datë 1.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Hydropower’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve të paluajtshme të saj”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Hydropower” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhimi 2 *mm*, në Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 307, datë 30.11.2022.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1589 prot., datë 23.4.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të shoqërisë “Hydropower” sh.p.k., në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 101, datë 12.5.2025, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydropower” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1589/3 prot., datë 14.5.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim. ERE nëpërmjet shkresës nr. 1566 prot., datë 16.4.2025, ka njoftuar gjithashtu edhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për këtë vendimmarrje.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1589/4 prot., datë 28.5.2025, depozitoi një

pjesë të dokumentacionit/informacionit të kërkuar nga ERE, nga analizimi i të cilit u konstatua mungesa e listës së detajuar të aseteve fikse me vlerat përkatëse (pasi lista e përcjellë nuk kishte vlera). Ndaj ERE, me shkresën nr. 1589/5 prot., datë 11.6.2025, i kërkoj shoqërisë depozitim të sa më sipër, si dhe duke i risjellë në vëmendje se ERE shprehet vetëm nëse vlera totale e tyre është më e madhe se 150,000,000 lekë.

- Shoqëria nëpërmjet shkresës me nr. 1589/6 prot., datë 18.6.2025, ka shprehur se janë të paqartë mbi sa kërkuar nga ERE, ndaj kërkojnë një takim sqarues në lidhje me këtë aplikim. Si e tillë, nga ana e ERE-s, u vlerësua mbajtja e një seance dëgjimore për të cilën është njoftuar shoqëria nëpërmjet shkresës dhe *e-mail*-it respektiv, dhe në vijim seanca u mbajt në datën 23.6.2025.

- Gjatë seancës shoqëria sqaroi se do të saktësonte listën e aseteve fikse me vlerat përkatëse të tyre, e në rast se vlera do jetë nën 150,000,000 lekë, atëherë shoqëria do të kërkonte përfundimin e procedurës, por në të kundërt do të përcillte dokumentacionin e munguar.

- Së fundi, me shkresën nr. 1589/9 prot., datë 26.6.2025, shoqëria kërkoj ndërprerjen e procedurës së marrjes së autorizimit nga ERE duke qenë se nuk përmbushet kushti që vlera e aseteve të jetë më e madhe se 150,000,000 lekë, siç është përcaktuar në rregulloren në fuqi.

- Neni 64, pika 2, i ligjit 45/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikon se, *një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative.*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 12.5.2025, “Mbi fillimin e procedurës lidhur me kërkesën e shoqërisë “Hydropower” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj”.



2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Hydropower” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË Nr. 306/7, datë 24.7.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitim/ rikonstruksion i Urës së Viroit”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 700,000 (shtatëqind mijë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “vresht”, bazuar në pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, i ndryshuar; marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligjin nr. 80/2023, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin ‘Ndërtimi i urave të qëndrueshme duke përdorur qasjen e programit me shumë faza’”, në bazë të të cilave është hartuar plani i veprimit të zhvendosjes, i shkurtuar, për projektin “Rehabilitim/ rikonstruksion i Urës së Viroit”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 700,000 (shtatëqind mijë) lekë.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIN RRUGOR “REHABILITIM/ RIKONSTRUKSION URA E VIROIT”

PRONARI				TE DHËNAT			VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT E PASURISË											VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME		
N/R	Emri	Adresa	Mbieuri	ZK	Nr. Pas.	Lloji Pas.	Sip. Totale (m2)	Shpronësim tokë "Vreshtë"			Shpronësim tokë "Trrall"			Ndërtësitë banimi (shtëpi)		Ndërtësitë jo banimi				Vl. kult. Bujq. Dru-frut. (lekë)	
								Sip. (m2)	Cmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sip. (m2)	Cmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sip.Ndërt. konf. ZVRPP (m2)	Cmimi mes. shpërbeje sipas zvrpp (l/m2)	Vlera (lekë)	Sip.Nd. konf.nga ZVRPP (m2)	Vlera sipas Preventivit (lekë)			
1	MIHAL	SOFO	CIKO	8541	110/1	VRESHTË	1000	41	6000	246.000			0			0		106.000	352.000	(Kartela e Pasurisë) SEKSIONI D TRUAJL BIE PIESËRISHT NË NDËRTIM I PALIGJISHËM	
2	ARBEN	MUTARREM	ZHUPA	8541	110/2	VRESHTË	1000	42	6000	252.000			0			0		66.000	318.000	(Kartela e Pasurisë) SEKSIONI D TRUAJL BIE PIESËRISHT NË NDËRTIM I PALIGJISHËM	
3	SADIK	MALIQ	KOTILI	8541	110/3	VRESHTË	1000	5	6000	30.000			0			0		0	30.000	(Kartela e Pasurisë) SEKSIONI D NDALOHEN VEPRIMET DIERNE PLOTËSIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR	
4	SHITET			8541	201/129	KANAL	1371	229	0	0						0		0			
5	SHITET			8541	201/71	RRUGË	5048	540	0	0						0		0			
6	SHITET			8541	201/109	LEDH	997	64	0	0						0		0			
SHUMA				PARAPRAKE																700.000	

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, me vendimin nr. 171 (33-2025-584), datë 13.5.2025, vendosi shpalljen të zhdukur, më datë 5.11.2007, të shtetasit Fadil Seferi, i datëlindjes 10.10.1963, lindur në Arap i Poshtëm, Dibër, si dhe caktimin si kujdestare të pasurisë së tij, bashkëshorten e tij, shtetasen Katerina Seferi.



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë

